



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

19 - 21 Mars 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Maqedonia, e para me lindje nga nëna 18-19 vjeçe

Shkup, 19 mars - Vetëm 1.6 për qind e femrave të moshës 15-19 vjeçe përdorin kontraceptivë oral kundër shtatzënisë, derisa 34.8 për qind kanë përdorur prezervativë për mbrojtje nga sëmundjet e transmetueshme seksuale në marrëdhënien e fundit seksuale me partnerët e tyre!

Për dallim nga vendet evropiane, Maqedonia ka nivel dukshëm më të ulët (22 për qind) të mbrojtjes nga sëmundjet e transmetueshme gjatë marrëdhënieve seksuale. Kështu thuhet në hulumtimin më të ri të Asociacionit për shëndet dhe edukim seksual HERA, sipas të cilës, vetëm 1 për qind e të rinjve dikur i janë nënshtruar testit HIV.

Në Maqedoni, thuhet në hulumtim, shkalla e lindjes te femrat e moshës 18-19 vjeçe në 1000 gra arrin në 22.3, për dallim nga Sllovenia ku kjo shifër është 4.8 dhe në Holandë 5.3. "Në nivel vjetor, janë 3000 klientë që shfrytëzojnë shërbime në qendrat për të rinj, për shëndetin riprodhues dhe seksual. Këta qendra u mundësojnë të rinjve të marrin shërbime për kontroll gjinekologjik, Ehokontroll, HIV-test dhe testime për infeksione të tjera seksuale dhe të gjitha me terapi dhe këshillim falas", tha kryetari i shoqatës HERA, Bojan Jovanovski.

Ai u ankua se, hulumtimi i shoqatës që drejton ai ka nxjerrë në pah problemin me mosinformimin e të rinjve rreth sëmundjeve të transmetueshme seksuale në shkolla. "Në Maqedoni nuk i kushtohet rëndësi mësimit për edukimin seksual. Vetëm 10-20 për qind e të rinjve mësojnë për përdorimin e kontraceptivëve dhe krijimin e familjes, e që realizohen në lëndën e Biologjisë ose arsimin për shkathtësi jetësore. Megjithatë, po rritet tendenca për informimin e njerëzve për infeksionet seksuale në kategorinë e të rinjve", tha Jovanovski.

Ai përmendi Komunën e Shuto Orizares, e cila numëron 8000 vajza dhe gra, por që për 10 vite nuk ka gjinekolog amë.

Dy vjet nga operacioni i parë në Kardiokirurgjinë shtetërore

Shkup, 19 mars - Me 20 deri në 30 operacione në muaj dhe 90 për qind sukses i rasteve të rënda dhe urgjente, kardiokirurgjia shtetërore po zhvillohet me sukses dhe gjithnjë e më shumë merr kredibilitet, jo vetëm te pacientët, por edhe te opinioni profesional.

Siç tha sot ministri i Shëndetësisë Nikollja Todorov, me rastin e dyvjetorit nga operacioni i parë i Kardiokirurgjisë shtetërore, Klinika i ka implementuar standardet më të reja dhe më bashkëkohore në



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



mjekimin, zbaton procedura më bashkëkohore dhe ka pajisje më bashkëkohore, ndërsa nga viti 2015, përveç punëve kardiokirurgjike, punon edhe në procedura vaskulare.

Todorov paralajmëroi zgjerim të ekipit në pjesën e kirurgjisë vaskulare me pranimin e dy mjekëve të cilët do të dërgohen në specializim ose subspecializim, Në plan është, theksoi, edhe përforcimi i ekipit të anesteziologëve me tre mjekë shtesë dhe personel mjekësor.

Sipas dr. Sashko Jonev, numri i intervenimeve rritet, si dhe shtrirja e punës.

Drejtori nënvizoi se në Kardiokirurgjinë shtetërore nga gjithsej dhjetë operacione urgjente, tetë deri në nëntë bërë mjaftë mirë, përderisa suksesi i të tjerëve është në korniza evropiane, me rreth 99 për qind sukses.

Nuk gjykohet gjinekologu maqedonas, ai akuzohet se është fajtor për vdekjen e pacientes

Shkup, 18 mars - Me kërkesë të avokatit mbrojtjes, sot në Gjykatën Themelore në Tetovë u shty gjykimi kundër gjinekologut nga Spitali Klinik i cili dyshohet për vdekjen e gruas shtatzënë, Violeta Kirovska në gushtin e vitit të kaluar.

Kontrollin kryesor, gjykatësi Hajrulla Idrizi e shtyu për me 7 prill.

“Në shkurt, Prokuroria Themelore Publike në Tetovë ngriti aktakuzë kundër gjinekologut për kryerjen e veprës penale-Vepra të rënda kundër shëndetit të njerëzve. E ngarkoi edhe për veprim jo adekuat gjatë ofrimit të ndihmës mjekësore, për shkak të së cilës është shkaktuar vdekja e një personi.

Në gushtin e vitit të kaluar, gjatë kryerjes së lindjes cezariene mbi një paciente, personi i akuzuar nuk i ka marr të gjitha masat preventive për mbrojtje nga shkaktimi i pasojave të rënda, të cilat, në rastin konkret kanë qenë tejet evidente.

Gjegjësisht, gjinekologu, pas shkaktimit të gjakderdhjes nuk ka kryer intervenim të shpejtë mjekësor për të penguar gjakderdhjen e shumë, por intervenimin e ka kryer me vonesë kur ka qenë e ditur se gjendja shëndetësore e pacientes është dëmtuar në mënyrë serioze.

Për shkak të reagimit të vonuar, pacientja ka qenë në shok. Në një gjendje të tillë është dërguar në Qendrën Klinike në Shkup ku edhe ka vdekur.”, thuan nga Prokuroria Themelore Publike në Tetovë.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



TETOVA

shpejt dhe ndryshe

Shënohet dita botërore e personave me sindromin Daun

СИТЕ ВО ИСТ СВЕТ ЖИВЕЕТЕ

21 МАРТ - СВЕТСКИ ДЕН
НА ДАУНОВ СИНДРОМ



Në organizim të shoqatës “Tiromisia 21” sot do të shënohet Dita botërore e personave me sindromin Daun – 21 mars, me qëllim që t’i jepet përkrahje këtyre fëmijëve dhe të rinjve.

Në suaza të skenës së vogël në objektin e ri të Teatrit popullor të Maqedonisë katërmëdhjetë fëmijë dhe të rinj – anëtarë të shoqatës më të vjetër dhe më të numërt me ndihmë dhe përkrahje të personave me Sindromin Daun, do ta kryejnë prezantimin “Pinokio” dhe do të prezantohen me disa pika muzikore. Do të ketë edhe pika të vallëzimit të anëtarëve të shoqatës, si dhe pjesëmarrje të grupit folklorik dhe të studentëve nga Akademia muzikore.

Prezantimi “Pinokio” në të cilën aktorë janë fëmijët dhe të rinjtë me sindromin Daun është produkti i dytë i pavarur i kësaj shoqate, si rezultat i përpjekjeve vullnetare të prindërve, pas prezantimit “Në botën e përrallave”, e cila ishte prezantuar në “Teatrin për fëmijë dhe të rinj” në vitin 2014. Shoqata ka për qëllim në aktivitetet e saj të përfshijë numër sa më të madh të personave me sindromin Daun, me qëllim që ta zgjojë entuziazmin dhe t’i motivojë edhe ato persona me potenciale më të vogla. Motoja e kësaj Shoqate është – Të gjithë mundemi, nëse mundohemi dhe nëse duam!

Do të përforcohet mbrojtja e fëmijëve dhe qasja drejt shërbimeve sociale



“Përmes marrëveshje sociale drejt qëndrueshmërisë” është titulli i projektit i cili do të prezantohet sot, ndërsa është në drejtim të sigurimit të një mjedisi të volitshëm për marrëveshje sociale në sferën e mbrojtjes së fëmijëve dhe ofrimit të shërbimeve sociale.

Në këtë mënyrë duhet të mundësohet qëndrueshmëri financiare afatgjate për organizatat qytetare dhe të përmirësohet efikasiteti dhe qasja drejt shërbimeve sociale.

Projekti financohet prej BE-së, ndërsa do të zbatohet përmes SOS Fshatit për fëmijë Maqedoni në bashkëpunim me Ministrin e Punës dhe Politikës Sociale, qendrat për punë sociale, Entin për veprimtari sociale.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Shtatë refugjat nga kampi i refugjatëve në Tabanoc përfundojnë në spitalin e Kumanovës



Shtatë refugjat nga kampi i refugjatëve në Tabanoc kanë përfunduar në spitalin e Kumanovës për shkak të problemeve me shëndetin, transmeton TetovaSot.

Sipas informacioneve nga Qendra Rajonale për Menaxhimin me Krizat, një sirian është dërguar në Departamentin Intern në Spitalin e Kumanovës ku pas ndërhyrjes mjekësore është kthyer në Tabanoc.

Në Departamentin e Fëmijeve kanë përfunduar katër fëmijë nga Siria dhe dy nga Afganistani, pas kryerjes së kontrollit të njëjtë janë kthyer në Tabanoc. /TetovaSot

Raporti i OBSH: 60 % e fëmijëve në Maqedoni i lajnë dhëmbët me rregull



Vetëm 60 % nga banorët 15 vjeçar të Maqedonisë hanë mirë, por të njëjtë janë kampion në Evropë sipas ngrënies së gjërave të ëmbla, transmeton TetovaSot.

Fëmijët tanë duan shumë pije freskuese të gazuara, një e treta prej tyre hanë perime çdo ditë, dhe aq merren me sport. Më shpesh janë në dietë, ndërsa vetëm 60 % prej tyre në mënyrë të rregullt i lajnë dhëmbët.

Këtë gjë po e tregojnë të dhënat nga raporti "Rritja jo e njëjtë: dallimet gjinore dhe socio-ekonomike në shëndetin dhe gjendjen e mirë e të rinjve", i cili raport përpilohet çdo katër vite në 42 vende nga Evropa, Amerika Veriore dhe Rusia nën drejtimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë./TetovaSot



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



PORTALB
dritare realiteti

Dita Botërore e Shëndetit të Gojës; Maqedoni- 40% e fëmijëve nuk i lajnë dhëmbët!



40% e fëmijëve në Maqedoni nuk kujdesen për higjienën e gojës. Fëmijët e Maqedonisë janë kampion në botë në ngrënien e ëmbëlsirave thuhet në mes tjerash në raportin e Organizatës Botërore për Shëndetësi.

Fëmijët tanë duan shumë pije freskuese të gazuara, një e treta prej tyre hanë perime çdo ditë, dhe aq merren me sport. Më shpesh janë në dietë, ndërsa vetëm 60 % prej tyre në mënyrë të rregullt i lajnë dhëmbët.

Këtë gjë po e tregojnë të dhënat nga raporti “Rritja jo e njëjtë: dallimet gjinore dhe socio-ekonomike në shëndetin dhe gjendjen e mirë e të rinjve”, i cili raport përpilohet çdo katër vite në 42 vende nga Evropa, Amerika Veriore dhe Rusia nën drejtimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.



Maqedonia e shënon ditën botërore të turbekulozit



Mekanizmi kordinues kombëtar dhe Instituti i sëmundjeve të mushkërive të bardha me përkrahje të Ministrisë së Shëndetësisë sot do ta shënojnë 24 marsin – Dita botërore e turbekulozit në Shkup.

Në suaza të shënimit është planifikuar të mbahet konferencë shtypi në të cilën do të drejtohen përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, nga Instituti i turbekulozit dhe nga Mekanizmi kordinues kombëtar, ndërsa është organizuar edhe treyzë e



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



rrumbullakët në të cilën do të debatohet për gjendjet dhe sfidat me këtë sëmundje. /Telegrafi/



Do të përforcohet mbrojtja e fëmijëve dhe qasja drejt shërbimeve sociale

"Përmes marrëveshje sociale drejt qëndrueshmërisë" është titulli i projektit i cili do të prezantohet sot...



"Përmes marrëveshje sociale drejt qëndrueshmërisë" është titulli i projektit i cili do të prezantohet sot, ndërsa është në drejtim të sigurimit të një mjedisi të volitshëm për marrëveshje sociale në sferën e mbrojtjes së fëmijëve dhe ofrimit të shërbimeve sociale.

Në këtë mënyrë duhet të mundësohet qëndrueshmëri financiare afatgjate për organizatat qytetare dhe të përmirësohet efikasiteti dhe qasja drejt shërbimeve sociale.

Projekti financohet prej BE-së, ndërsa do të zbatohet përmes SOS Fshatit për fëmijë Maqedoni në bashkëpunim me Ministrin e Punës dhe Politikës Sociale, qendrat për punë sociale, Entin për veprimtari sociale./Mia



Maqedoni, sot shënohet dita botërore e personave me sindromin Down



Në organizim nga shoqata "Trisomija 21" sot do të shënohet Dita Ndërkombëtare e Personave me Sindromën 'Down' – 21 mars në mënyrë që të jepet mbështetje për këta fëmijë dhe të rinjë, transmeton Telegrafi Maqedoni.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Në kuadër të skenës së vogël në ndërtesën e re të Teatrit Kombëtar maqedonas, katërbëdhjetë fëmijë dhe të rinjë – anëtarët më të populluar dhe më të vjetër të shoqërisë për të ndihmuar njerëzit dhe mbështetur personat me sindromën Down, do të performojnë me shfaqen “Pinokio”, dhe do të paraqesë disa shfaqje muzikore. Do të ketë edhe një numër të vallëzimeve të anëtarëve të shoqatës, si dhe performanca të grupit folklorik të studentëve të Akademisë së Muzikës.

Shfaqja “Pinokio”, në të cilën aktorët janë fëmijët dhe të rinjtë me sindromën Down, është prodhimi i dytë i pavarur i kësaj shoqate si rezultat i përpjekjeve vullnetare të prindërve në shfaqjen “Në botën e përrallave”, e cila është kryer në “Teatrin për fëmijë dhe të rinj” në 2014.

Shoqata ka për qëllim që në aktivitetet e saj të përfshijë sa më shumë njerëz me sindromin Down për të nxitur entuziazmin dhe motivojë ata njerëz me potenciale me nevoja të veçanta. Motoja e kësaj shoqate është – Të gjithë ne mundemi, nëse përpiqemi dhe nëse dëshirojmë!